FAMILJA DHE RËNDËSIA E SAJ

BESIMTARI PËRBALLË VËSHTIRËSIVE DHE SPROVAVE

NË RAHMET TË ALLAHUT, ERUDITI ISLAM H. ISMAIL MUÇEJ

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 18 - Nr. 12 (214), Dhjetor, 2020

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Marrëveshja e Paqes e Utbe ibn Ferkadit

Në emër të Zotit, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Kjo është çfarë Utbe ibn Ferkad, nëpunësi i Omer ibn El-Khattab, Prijësit të Besimtarëve, u dha popullit të Azerbajxhanit:

Fushat e vendit, malet, skajet dhe brigjet e tij, edhe ndjekësit e feve të ndryshme në vend, të gjithëve atyre u jepet siguria për veten e tyre, pasurinë, fenë dhe legjislacionet e tyre, me kushtin që ata të paguajnë xhizjen, aq sa kanë mundësi;

Gjë të cilën nuk e ka detyrë fëmija, as gruaja, as nuk është detyrë në kohën kur njeriu s'ka asgjë në dorë nga pasuria e kësaj dynjaje, as njerëzit që qëndrojnë vetëm në tempuj duke u marrë me adhurime dhe që nuk kanë në dorë asgjë nga pasuritë e kësaj bote.

Këtë të drejtë e kanë ata, edhe ata që banojnë me ta, kurse kanë detyrë ta akomodojnë për një ditë dhe një natë myslimanin që është ushtar i ushtrisë së myslimanëve, edhe ta njoftojnë atë për çfarë i pyet.

Ata të cilët largohen në ndonjë vit nga vendi, ata nuk e kanë detyrë të paguajnë atë vit, kurse kush vjen dhe qëndron në këtë vend, ka detyrim si ata që banojnë aty;

E, kush del në udhëtim, është i mbrojtur derisa të hyjë në strehën e tij.

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

MUNDËSIA PËR TË QENË MËKËMBËS I ZOTIT NË TOKË!

(OSE: RRUGËTIMI YNË KA NEVOJË PËR NDRYSHIM KURSI!)

Kur'ani na nxit ta trashëgojmë Tokën, duke dhënë më të mirën tonë për të ndërtuar vlera e dobi për jetën mbi të! Në këtë kontekst, të gjithë jemi të përfshirë në këtë Thirrje të shenjtë, në veçanti prijësit fetarë dhe pushtetarët e përkohshëm.

Të parët, pra, prijësit fetarë, duke ruajtur kufijtë e misionit të shenjtë të udhëzimit të njeriut, si dhe duke u bërë përhapës të së mirës dhe harmonisë, larg fanatizmit të verbër, larg mendësive të dominimit a përçmimit të tjetrit, kushdo qoftë ai, larg tendencave që krijojnë cytje të panevojshme, veprimi i të cilave hedh poshtë krejt punën e mirë të ndërtuar me përkushtim e shembull qytetërues!

Nuk ka asnjë vlerë tek Zoti, asnjë mur i vdekur, para një komuniteti, që duhet mëkuar me frymën e paqes dhe harmonisë, në rrugëtimet e një jete të shkurtër, aq sa Zoti e ka shkruar për njeriun mbi Tokë!

Të dytët, pra, pushtetarët, duke respektuar fillimisht vetveten, duke mos kaluar kufij që nuk duhen kaluar e prekur në marrëdhënie me të tjerët e, mbi të gjitha duke shërbyer me përulësi për popullin dhe hallet e tij!

Përderisa nuk respektohet besimi, jeta dhe prona; përderisa nuk vlerësohet intelekti dhe nuk peshohet me xhelozi, krenari e ujë fytyre nderi, do të thotë se ekuilibrat e jetës janë prishur dhe rrugëtimi ynë ka nevojë për ndryshim kursi!

Përderisa nuk i zgjidhim problemet e të rinjve; me ligje të qarta dhe të mbara për arsimin e lartë, krijimin e mundësive për zhvillimin e arsimimit në kushte bashkëkohore, zgjidhjen përfundimtare të problemeve të banimit, krijimin dhe hapjen e mundësive të punësimit, lehtësimin e rrugëve për krijimin e familjeve të reja, miratimin e ligjeve të prera kundër abortit selektiv, por jo vetëm, përpjekjes së vazhdueshme për eliminimin e papunësisë, për shfrytëzimin e pasurive me të cilat na begatuar Zoti; "nuk do të nderohemi në botë, as do të nderohet feja e jonë dhe, kjo është një e vërtetë e hidhur", që duhet ta themi me të madhe, duke iu bashkuar krejt zërave të qytetëruar që me dinjitet kërkojnë ndryshimin e të keqes së përhapur në masë dhe heqjen e barrave mbytëse, të padrejta dhe krejtësisht korruptime nga jeta e shqiptarëve, për të cilat kemi tërhequr vëmendjen prej vitesh nëpërmjet predikimeve, thirrjeve të shumta dhe këshillimeve komunitare, në kontekstet e hakut të shtëpisë sonë të përbashkët, Tokës dhe jetës me dinjitet mbi të!

Kur njeriut i paqtohet zemra dhe i piqet mendja, kur i rriten ndjenjat dhe i ndizet arsyeja, i ekuilibrohet mendja dhe zemra; kështu ai bëhet i mundur për të qenë mëkëmbës i Zotit mbi Tokë!

Atëherë, kur njeriut i paqtohet zemra dhe i piqet mendja, kur i rriten ndjenjat dhe i ndizet arsyeja, i ekuilibrohet mendja dhe zemra; kështu ai bëhet i mundur për të qenë mëkëmbës i Zotit mbi Tokë!

Shkodër, më 11 dhjetor 2020

"SI T'I KISHTE MBYTUR GJITHË NJERËZIT..!"

Nga ajeti 32 i sures El-Maide: "... kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që ai të jetë gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit...".

Ibn Kethiri*, duke komentuar ajetin 32 të sures El-Maide, sjell edhe një transmetim të sahabiut Ebu Hurejra (r.a), i cili tregon për dialogun e tij me të parin e muslimanëve, Hz. Osmanin (r.a), ditën kur e vranë në shtëpinë e tij teksa lexonte Kuran: "Hyra tek Osmani, ditën ngjarjes dhe i thashë: Kam ardhur të të përkrah, o prijës i besimtarëve!

Tha: O Ebu Hurejra, a të gëzon ty të vrasësh krejt njerëzit, edhe mua me ta?

Thashë: Jo!

Tha: Nëse ti vret një person të vetëm, është sikur të kesh vrarë mbarë njerëzimin. Largohu, me lejen time, i shpërblyer, jo i ndëshkuar!

Thotë (Ebu Hurejra): U largova dhe nuk luftova!".

Ibn Abbasi (r.a), në komentimin e pjesës: "është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit", thotë: "Ai që vret një njeri të vetëm, që Allahu e ka bërë haram, është si të kishte vrarë mbarë njerëzimin!".

Said ibn Xhubejri thoshte: "Ai që ia lejon vetes gjakun e një muslimani, është si t'ia kishte lejuar vetes gjakun e mbarë njerëzimit. Ndërsa ai që ia ndalon vetes gjakun e një muslimani, është si t'ia kishte ndaluar vetes gjakun e mbarë njerëzimit!".

Thotë Ibn Xhurjexh: Ka thënë Muxhahidi: "(Rreth pjesës së ajetit:) 'E kush e ngjall (bëhet shkak që ai të jetë gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit', dmth: Ai që nuk vret njeri, njerëzit kanë shpëtuar prej tij!".

.....

- *El-Misbahul-Munir fi tehdhibi tefsiri Ibn Kethir*, nën kujdesin e Shejkh Safijurrahman Elmubarekfuri, Kuvajt, pa vit botimi, f. 372.

* Imam Ismail ibn Omer ibn Kethir (v. 774 h.).

.....

Me përshtatje nga arabishtja:

Muhamed Bardhyl Sytari

Shkodër, 9 dhjetor 2020

25 DHJETORI I ÇDO VITI...

25 dhjetori i çdo viti është një datë e shënuar për botën e krishterë. Gjithandej, përgatitjet për mbërritjen e kësaj dite, ndezin sheshe e rrugë me zbukurime e shenja, që lidhen me atmosferën e kësaj dite.

Para ca ditësh po ndiqja një dokumentar mbi Sirinë dhe civilizimin, ndërthurjen e kulturave dhe bashkëjetesën e të ndryshmeve në diversitetin e larmishëm mbi atë tokë të bekuar.

Më erdhën ndër mend ditët e para të viteve të studimit në Damask, kur në xhami dëgjoje edhe ligjërime, ku fjalia: "Vëllezërit tanë nasara kanë festë!", ishte normale dhe logjike. Sepse, ne jemi të ftuar të ndërtojmë ura, duke ruajtur ekuilibra, duke respektuar kufij e duke hapur zemrën në drejtim të njeriut, cilitdo njeri; të respektojmë e të respektohemi, duke rrugëtuar së bashku në ndërtimin e tokës e atdheut, njeriut dhe vlerave!

Kujtoj zbukurimet e lagjes së vjetër Bab Tuma, ku të krishterët damaskenë të jepnin selam e të thonin: "Allahu të ruajtë!", duke të buzëqeshur, në rutinën e një komunikimi normal, në një shoqëri të qytetëruar e mbi të gjitha besimtare. Ishin zbukurime me shije e të pangarkuara, të ndjera e në kufijtë e logjikës së një festimi krejtësisht legjitim në realitetet e një bashkëjetese racionale, në një shoqëri, ku toleranca e shpirtit e forca e ndërgjegjësimit të kulturuar fetar ndërton njerëz e shoqëri me ekuilibër, jo fanatikë të verbër e tinzarë të pagdhendur, që duan të të imponohen dhunshëm, në shfaqjet e pamaskueshme dot të komplekseve të panevojshme, siç natyrshëm dëshmojmë përgjatë historisë e deri në ditët e sotme me shoqëri e grupime, që shpesh, në emër të fesë kanë bërë tregëti të pandershme me ndjenjat e besimin e shtresave të paformuara e të paarsimuara në shoqëritë njerëzore.

Kujtoj shumë mirë pjesëmarrjen në darkën e kortezisë së shtruar nga Patriarkana Orthodhokse e Lindjes, me rastin e vizitës së kryepeshkopit të Etiopisë në Siri. Ishte nëntori i vitit 2008, e mbaj mend mirë. Në atë atmosferë po takoja për herë të parë edhe dy personazhe të shquar të frymës së dialogut e harmonisë ndërfetare në Siri, kryepeshkopin orthodhoks të Lindjes dhe të mbarë botës, Agnatios IV Hezim, si dhe kryepeshkopin e orthodhoksëve sirianë Zeka Ivas, të cilët i kisha parë shumë herë në xhaminë e shkollës sime, kur vinin për të uruar Kryemyftiun e Sirisë, Shejkh Ahmed Keftaro, në pritjet tradicionale me rastin e bajrameve, aktiviteteve ndërfetare, a tribunave të shumta, ku hoxhallarë e priftërinj i shihje bri njëri-tjetrit, në një kornizë të pasforcuar e krejtësisht natyrale...

E, siç dëgjonim në xhamitë e Shamit Sherifë, në çdo fundvit: "Vëllezërit tanë nasara kanë festë!", festë e gëzime pastë përherë në jetën e njeriut, që kërkon nëpërmjet besimit, lartësimin për të jetuar me dinjitet e për të dhuruar dashuri, për të ndërtuar me aftësi e për të mos devijuar për asgjë e për asnjeri, nga Drita e Zotit, nga Udhëzimi i Tij, nga rruga që shpie drejt trupëzimit me vullnet e krenari të thirrjes së shenjtë: "O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj që ju krijoi...".

Sot, kur kthej kokën pas, dashurohem pambarimisht dhe bindem edhe më shumë në madhështinë e shfaqjes së Pejgamberit të njerëzimit dhe vulës së më të dashurve të Zotit, Hz. Muhammedit (a.s), me shfaqjen e të cilit, njerëzimi mësoi se tjetri respektohet, pritet e nderohet, komunikohet me të dhe dialogohet, ndërtohen ura e shtrëngohen duar, ndihmohet e tolerohet, mbështetet e përkrahet, duke dëshmuar shembujt më të mirë të vlerave të thirrjes hyjnore: "O ju Njerëz..!", në sipërfaqen e Tokës, prej baltës së të cilës jemi krijuar e në dheun e saj do kthehen trupat tanë.

25 dhjetori i çdo viti... Sivjet, njëjtë si Ramazani që kaloi e Mevludi Sherifë, atmosfera e të cilit vazhdon të rrezatojë dritën e mësimeve të udhëzimeve të shtrenjta drejt ruajtjes së dinjitetit njerëzor, shpirtmadhësisë, drejtësisë, paqes, mbrojtjes së të drejtave të dhimmitëve në shoqëritë tona, por jo vetëm; edhe të krishterët e vendit tim janë të detyruar të përkufizohen me protokollet e këtij realiteti të imponuar dhunshëm e kësaj propagande sfilitëse për njerëzimin, me lutjet e secilit që Zoti ta ruajë njerëzimin nga çdo e keqe e njeriut pa besim e fé, që prodhon të keqen, që gjeneron komplote kundër racës së tij e, që mendon e beson se Zoti nuk sheh e nuk mund ta shuajë zjarrin e të keqes kundër jetës dhe ekuilibrave të saj mbi tokë!

Janë ditë të ngarkuara me stres e lodhje, me lajmërime vdekjesh e ndarje nga të dashurit, me padrejtësi e dhunë, me humbje ekuilibrash mendorë e shfaqje injorance të tejskajshme, edhe nga ata, prej të cilëve pritet shërbimi ndaj njerëzve e shoqërisë, jo arroganca e pakuptimtë, që natyrshëm nuk do vazhdojë përgjithmonë...

Janë ditë, kur njerëzit kanë të drejtë të marrin pak pushim nga krejt kjo zamallahi e rëndesë e sprovave të këtij viti, që mbi të gjitha na ftojnë për të reflektuar e besuar, për t'u kthyer tek origjina e për të dëbuar me krejt forcat të keqen dhe shthurjen ndër ne, për të formatuar krejt sistemin e të arsyetuarit e të udhëzuarit drejt Zotit dhe Thirrjes së Tij... Është koha për të "ba tobe", siç na mësonin gjyshërit me tespihë në dorë..!

E, siç dëgjonim në xhamitë e Shamit Sherifë, në çdo fundvit: "Vëllezërit tanë nasara kanë festë!", festë e gëzime pastë përherë në jetën e njeriut, që kërkon nëpërmjet besimit, lartësimin për të jetuar me dinjitet e për të dhuruar dashuri, për të ndërtuar me aftësi e për të mos devijuar për asgjë e për asnjeri, nga Drita e Zotit, nga Udhëzimi i Tij, nga rruga që shpie drejt trupëzimit me vullnet e krenari të thirrjes së shenjtë: "O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj që ju krijoi...".

25 dhjetori i çdo viti...

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, 25 dhjetor 2020

HOMAZH PËR ERUDITIN ISMAIL MUÇEJ

Me 28 shkurt 2017, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë organizoi një konferencë me rastin e 25 vjetorit të gazetës "Drita Islame". Pa dyshim, një ndër personazhet më të spikatura dhe elitare të këtij 25 vjetori ishte kryeredaktori i parë i saj, eruditi dhe studiuesi skrupuloz, Ismail Muçej.

Sot, në moshën 96 vjeçare, ai kaloi nga kjo botë drejt mëshirës së Allahut, pas një jete të gjatë të mbushur me ngjarje e stacione, episode e personazhe, sa për të mbushur një vepër vëllimore, sa vëllimet e dorëshkrimet e stilit të zotni Smajlit, rahmet pastë.

Zotninë e tij e kam njohur që nga koha e fillimit të aktivitetit të Myftinisë Shkodër, ato ditë kir selia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ishte në Shkodër e, kur Hafiz Sabri Koçi ishte më afër nesh e kur Hirësia e Tij shprehej edhe pa folur me imazhin e tij tërheqës, çallmën e bardhë e xhyben e zezë, parfumin e mirë e mjekrën e bardhë, nurin e Hoxhës që i bënte për vete njerëzit vetëm me pamjen e jashtme, pa përmendur kur merrte të fliste e të ndizte zemrat me ligjërimet e tij të mrekullueshme, elokuencën, stilin, përmbajtjen e mesazhet që përcillte nga java në javë, nga takimi në takim.

E, në këtë atmosferë të bekuar, që na tërhiqte me sirret e sinqeritetit të zemrave drejt Komunitetit tonë, zotni Smajli, ishte ndër personazhet që binte në sy, me karakteristikat e personalitetit të tij, me përkushtimin e drejtimit të gazetës "Drita Islame", që mezi prisnim të dilte, me vitet e burgut mbi supe, me zhgënjimet e rinisë së goditur pabesisht, me durimin e sabërlive të periudhave të shkuara të historisë së pasur islame, me zellin e dëshirën për një rizgjim të ri, që sapo kishte nisur t'i agonte dielli e, për të cilin kontribuoi e dha, aq sa veç Zoti Një e di e, për të cilin lutemi e shpresojmë ta shpërblejë me mirësitë e mëshirën e Tij të pakufijshme.

Sonte, kur mora lajmin e ndarjes së tij nga kjo botë, u luta për shpirtin e tij dhe në heshtje e falënderova për gjurmët e kontributet e mëdha; të dukshmet dhe ato që akoma nuk e kanë parë dritën e diellit!

Pastaj, m'u kujtua një prej takimeve të shumta. Ishte verë e vitit 1994. Gazeta "Drita Islame", sapo kishte botuar një artikull, rreth të cilit kisha

disa mendime, që gjykoja (akoma vazhdoj ta mendoj ashtu), se ai artikull nuk kishte vend në gazetën tonë.

Gjithsesi, ishin vitet e fillimit dhe, natyrshëm, stafi i gazetës mund të kishte gjykuar se politika e tolerancës ndaj artikullshkruesve duhet të dominonte, për shkak edhe të kushteve të kohës, mungesës së kuadrit e, për pasojë, edhe të cilësisë së ndonjë shkrimi. Pavarësisht se, ato vite, gazeta e jonë ofronte artikuj të goditur e analiza të thella, që s'para i lexojmë më sot! Kushedi se pse..!?

Kur e diskutuam me zotni Smajlin, duke buzëqeshur, teksa mori të më tregonte se kishte qenë në një udhëtim, ma ktheu: "Kur nuk asht i zoti i shtëpisë në shtëpi, minjtë hedhin valle!".

Rahmet pastë shpirti i tij dhe drita e simbolikës që rrezaton emri i tij, u bëftë shkak që disa vepra me emrin e tij të dalin në pah dhe, një studim (profesional) monografik rreth personalitetit, gjurmëve, dorëshkrimeve, studimeve e shkrimeve të botuara dhe kontributeve të tij, të dalë në pah, si një pasuri për të sotmen dhe të ardhmen e historisë sonë dhe personaliteteve të shquara që jetuan duke bërë Dritë!

Dhe, për një moment kthej kokën pas, për të gjetur një listë të heshtur që peshon më shumë se vite të humbura e njerëz pa gjurmë, por edhe më shumë se shfaqje pa përmbajtje e realitete pa dritë... Është lista e disa prej gjurmëve të eruditit dhe poliglotit Ismail Muçej:

- ***"Fjalori Arabisht-Shqip"***, me 45.000 fjalë dhe 20.000 shprehje prej 2.000 faqesh.
- ***"Fjalori Shqip-Arabisht"*** me 25.000 fjalë dhe 30.000 shprehje prej 1300 faqesh.
- ***"Metodë e mësimit të gjuhës arabe"***, e përkthyer në shqip. Autorësi e Gaspary Otto Sauer, orientalist i shquar gjerman.
- ***"Feja dhe misioni i saj"***, me 350 faqe.
- **"Pse përqafova Islamin"**, 120 faqe.
- "Pohime të një spiuni anglez", 70 faqe.
- ***"Rendi i ri botëror"***, 100 faqe.
- ***"Si arriti Kur'ani deri në ditët tona"***, 70 faqe etj.

Besimtar, atdhetar, musliman krenar, durimtar ndaj zullumeve, i sprovuar në besim, mësues, edukator, studiues, poliglot e përkthyes i dëshmuar, erudit i palodhur deri në frymën e fundit... Ismail Muçej...

Allahu e mëshiroftë dhe e lartësoftë gradën e tij në të përtejmen!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 14 dhjetor 2020

SOT, 4 VITE MË PARË, NË ÇANAKALE...

Jam i lumtur dhe plot optimizëm se, atë që e kam shkruar, sot katër vite më parë, veçse e shoh të trupëzuar ditë pas dite në realitetet e një bote të trazuar, që kërkon zgjidhje e alternativa shpëtimi..! Ky rrugëtim i shenjtë i rimëkëmbjes së ymetit nuk ka më kthim pas, përtej asaj që, shpesh pasqyron pesimizëm e mosbesim në realitetet që na mbërrijnë rrejshëm a turbullt..!? Përtej të vërtetave të dhimbshme, ka edhe shumë e shumë shenja të begata që ngacmojnë vetëdijen e besnikëve për t'u zgjuar, drejt rimëkëmbjes, drejt bashkimit e lidhjes së duarve në shërbim të këtij kerameti të madh për mbarë njerëzinë, përtej ymetit që po rikthehet..!

Në këtë rrugëtim të gjatë, patjetër që do të dalin në pah tradhtia, pabesia, frika e dinakëria, shitja e lirë e mungesa e dinjitetit nga brenda, krahas urrejtjes shekullore, histerisë së të paekuilibruarve mendërisht, islamofobëve dhe atyre që luajnë me dy a më shumë standarde në arenat ndërkombëtare në dëm të njeriut e jetës në ekuilibër me natyrën e ligjet e Zotit në të!

Të gjitha do të dalin në pah, për t'u pastruar çinari ynë shekullor nga gjethet e kalbura, si dhe për të dëshmuar se nuk ka goditje nga jashtë që e dëmton, a ia thanë rrënjët e përhapura gjithandej në nëntokën e këtij globi e në damarët e zemrave të miliardave, në çdo cep të botës, që Dritë i japin me zërin e pastër e të thekshëm të teuhidit!

Shkodër, 18 dhjetor 2020

"Ky ymet ringrihet mbi kujtesën e së shkuarës!"...

Është e pamundur ta vizitosh e të mos tërhiqesh pas këtij vendi të paqtë, edhe pa e njohur në thellësi dhe detaje historinë e tij...

Ka një frymë të padukshme, krejtësisht transparente, që të përshkon qenien, teksa shkel mbi këtë tokë...

Hapësira e madhe e saj, pozita gjeografike, mali, deti, terreni thuajse malor, gjelbërimi me shumëllojshmërinë e florës, e shumë detaje të tjera të ngulitura në memorie, e bëjnë të lakmueshme për t'u vizituar sërish, edhe pse je larguar prej saj...

Emri i kësaj toke, është emër i madh. Peshon rëndë dhe, madje, nuk ka të peshuar.

Në vetvete, ky emër mbart në vetvete një histori të madhe lavdie, sakrificash sublime, vetëmohimi e shtrëngim duarsh të shumta për një qëllim të shtrenjtë.., një qëllim që u kthye në histori mrekullie, me bekimet dhe përkujdesjen hyjnore të Zotit të gjithësisë...

Sot, u ula në gjunjë mbi këtë tokë të begatë! Ndjeva një emocion të madh, teksa prekja një nga simbolet e saj, mbi të cilin ishte shkruar emri i Shkodërloces së shtrenjtë, që i fali ymetit, në ditët e tij më të vështira dhe vendimtare, djemtë e saj më të mirë, në mbrojtje të dinjitetit, krenarisë, historisë së shekujve plot dritë teuhidi, paqeje, sigurie e drejtësie..!

Sot, u ndjeva krenar dhe i fortë, teksa lexoja emrat e nderuar të shehidëve të panumërt, nga Shkodra, Elbasani, Dibra, Mitrovica, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Tetova e, sa e sa qytete shqiptare e nga mbarë trojet e ymetit...

Sot, nga kjo tokë përhapej kudo drita e pashuar e lavdisë së martirëve të dinjitetit e krenarisë legjitime të këtij besimi, kësaj feje e këtij humanizmi të bekuar islam!

Sot, mesazhet që përhapeshin gjithandej në hapësirat e Çanakalesë, rrezatonin shpresë ripërtëritjeje, rizgjimi e rimëkëmbjeje të një ymeti, që Zoti e zgjodhi të jetë "Dëshmitar i Njerëzimit"... Sikur thonin: "Ky ymet ringrihet mbi kujtesën e së shkuarës!"...

Imam Muhamed B. Sytari
Çanakale, 18 dhjetor 2016

"Njerezija me gojë hapet
Rrinte, gjithnji ne mendim,
Vallë, si kurse shkruejnë
qitabet,
Kur kishin me gjete
shpetim?

Dijetaret pam' e kishin
Ne Ungjill e ne Teurat
Nji Profet ata po pritshin,
Kishte bâ Zoti murat.

Emni i bukur vet Ahmet,
Neper librat figuronte,
Por kur erdhi ne ket jet,
Zoti -Muhammed-
i thonte."

Hysni Halid Bushati, 1932

FAMILJA DHE RËNDËSIA E SAJ



Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

Familja në Islam është argument prej argumenteve të Allahut, duke u krahasuar krijimi i saj me krijimin e gjithë botës, Zoti (xh.sh) thotë: "Prej argumenteve të Tij, krijoi për ju, nga lloji juaj, bashkëshorte që preheni tek ato..." - (Kur'ani, Er-Rrum: 21) . Pastaj thotë: "Dhe prej argumenteve të tij, është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja". - (Kur'ani, Er-Rrum: 22)

Në jurisprudencën islame ekzistojnë kapituj të tërë për familjen, për rendin e saj material dhe për misionin e saj moral, për aktin e martesës, ku janë përcaktuar detyrat reciproke, kujdesi për fëmijët, llojet e shpenzimeve, mënyra e sjelljes dhe mënyra për ndarje, në rast se nuk ekziston asnjë mundësi për të jetuar më së bashku, sasia e trashëgimisë etj.

Gjithashtu, aty flitet edhe për ndikimet e lidhura shpirtërisht e moralisht me ekzistencën e familjes se, si familja shërben për vazhdimësinë e racës njerëzore dhe për parimet, adhurimet dhe moralet, të cilat Islami i ka urdhëruar dhe është ndërtuar mbi bazën e tyre.

Për të mbrojtur familjen, Islami ka ndaluar përzierjen shtazore, siç njihet në shumë vende të ndryshme, ka ndaluar çdo gjë që prek nderin dhe turpin!

Një miku im më ka thënë se: fjala "ird" me kuptimin e plotë të ndershëm, të pastër të saj, nuk mund të përkthehet në asnjë gjuhë tjetër!

Si të ketë kuptim kjo fjalë në ato lloj shoqërish ku lejohet të kërcejë burri me gruan e huaj, i hedh dorën dhe vallëzojnë së bashku në sallë dhe ndoshta burri i saj horr është i pranishëm, shikon dhe nuk i vjen zor aspak, ose mundet të jetë me babanë ose vëllanë e saj në mbrëmje!!

Familja në fenë tonë është e rrethuar me dëlirësi dhe me shenjtëri, që nuk gjendet në vende të tjera, mund të gjenden vetëm në letër, ose deri në një moshë të caktuar, pastaj në moshën e pubertetit, detyrohet djali apo vajza të çajnë rrugën e tyre për të fituar e jetuar.

Shoqëria në Islam është si një familje e madhe, e cila ngrihet mbi baza njohje e dashurie. Njerëzit në të gjithë rruzullin janë të barabartë, bindja e tyre është vetëm për Allahun dhe jo për racë, apo për atdhe. Më i ndershmi i tyre tek Allahu është më i devotshmi.

Baza e komunikimit dhe e marrëdhënieve është përcaktuar qartë në hadithin e të Dërguarit të Allahut (a.s): "Nuk është prej nesh ai që nuk respekton të moshuarin, nuk mëshiron të voglin dhe nuk e njeh të drejtën e mësuesit tonë".

Mburrja me anë të prejardhjes është e refuzuar, gjithashtu edhe me anë të shokëve e të miqve është e papranueshme. Zgjedhja e parësia i takon vetëm atij që e meriton dhe jo sipas origjinës dhe shquarjes. Duke nisur nga ky parim, u bënë ata që ishin robër, udhëheqës të botës islame, dolën në krye të fushave të fetfasë, në fikh, letërsi, gjuhë, ia kaluan arabëve që ishin të parët përkrahës të shpalljes, pastaj dolën në krye të fushës së politikës e drejtësisë. Gjithashtu, u ngritën shtete të skllevërve dhe racave të ndryshme, të cilët patën një ndikim të madh në shërbim të Islamit.

ISLAMI DHE GRUAJA

Gruaja myslimane është njeri sikur burri, ajo është motra e tij përpara të gjitha parimeve islame. Gruaja tek arabët ishte plaçkë pa vlerë dhe kur u lindte ndonjë vajzë, ajo varrosej për së gjalli, përbuzej shumë, madje në të kaluarën evropianët pyesnin: A ka shpirt gruaja sikur burri?

Në Indi, kur burri i saj sëmuret, ose vdes, ajo gjykohet me vdekje duke e djegur dhe nuk i lejohet gruas të jetojë pas vdekjes së burrit! Gjithashtu, Platoni shikonte në qytetin e tij utopik që, gruaja të jetë e përbashkët për të gjithë burrat!

Derisa erdhi feja islame, e cila ndryshoi të gjitha këto dukuri e paragjykime, e nxori gruan nga shtëpia për në xhami 5 herë në ditë, në qoftë se kjo gjë nuk e pengon atë në punët e saj, për fëmijët dhe burrin, duke e parë vetë ajo gjendjen e saj. Islami nuk e pengoi gruan nga xhihadi, të luftojë në qoftë se ka mundësi, bile është obligim për të dhe për burrat të gjithë kur është puna për të mbrojtur vendin.

Me të vërtetë, personaliteti i gruas lindi me ardhjen e mesazhit islam dhe, si argument për këtë kemi sjelljen e Pejgamberit (a.s) me gratë e tij, i cili i ndaloi vetes disa gjëra hallall, të lejuara për hir të grave të tij, që t'i kënaqte ato, derisa zbriti shpallja e Zotit (xh.sh): "O ti i Dërguar, përse ia ndalon vetes ato që Allahu t'i ka lejuar ty, ku me këtë gjë kërkon kënaqësitë e grave tuaja"? - (Kur'ani, Et-Tahrim: 1)

Mburrja me anë të prejardhjes është e refuzuar, gjithashtu edhe me anë të shokëve e të miqve është e papranueshme. Zgjedhja e parësia i takon vetëm atij që e meriton dhe jo sipas origjinës dhe shquarjes. Duke nisur nga ky parim, u bënë ata që ishin robër, udhëheqës të botës islame, dolën në krye të fushave të fetfasë, në fikh, letërsi, gjuhë, ia kaluan arabëve që ishin të parët përkrahës të shpalljes, pastaj dolën në krye të fushës së politikës e drejtësisë.

Më përpara, gruaja nuk e kishte gjithë këtë gjerësi në personalitetin e saj edhe pse çështja e saj mori drejtim tjetër, për të përmbysur zakonet e vjetra dhe jo si përputhje me parimet islame.

(shkëputur nga libri: Probleme në rrugën e jetës islame)

(Shkëputur nga libri:"Probleme në rrugën e jetës islame")

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

PLAGJIATURAT E PERËNDIMORËVE NË LIBRAT HISTORIK

Fuat Sezgin është një historian i madh Turk i cili jetoi në Gjermani qysh prej më shumë se gjashtëdhjetë vitesh. Mundohuni ta mbani mend këtë emër. Ky njeri e meritonte të merte çmimin Nobel, për të arriturat e tij.

Ky burrë qysh prej 60 vitesh punon në Frankfurt me një grup pune që ka në përbërje gjermanë, turq dhe arabë. Në një qendër të pavarur kërkimesh. E gjithë puna e tij është t'i kontrollojë librat perëndimorë të vjetër dhe ti kthejë në origjinën e tyre të mohuar zyrtarisht e që është origjina e tyre arabe.

Sot që po flasim, ai ka patur sukses që të arrijë tek 150.000 libra të vjetër evropianë dhe pas 60 vitesh ai bashkë me grupin e tij kërkimorë kanë arritur të kontrollojnë rreth 40.000 tituj të këyre librave dhe deri tani e kanë gjetur origjinën e tyre arabe të 35.000 librave. Ndërkohë njëri nga Universitetet Islame, ai i Muhamed bin Saudit në Rijad qysh herët e ka marë përsipër botimin e vëllimeve të para të librit dhe ato që kam unë qysh prej 30 vitesh i kanë kaluar dhjetë vëllimet.

ÇFARË BËN AI?!

E merr kopjen origjinale të librit evropian dhe më pas e ndjek origjinën dhe shikon se në origjinë ai libër është përkthim dhe ajo që ka bërë përkthyesi është heqja e emrit të autorit arab dhe vendosja e emrit të tij. Librat e përkthyer janë të lëmive të ndryshme si: optika, mjekësia, astronomia, kirurgjia, anatomia, bujqësia, detaria, lundrimi, sinoptika etj.

Prej kësaj perëndimi fitoi dy gjëra: Ata përvetësuan të gjitha njohuritë tona dhe në momentin kur i falsifikuan krijuan një vetëbesim sa të mos mundesh tu thuash se ju këtë e keni përvetësuar. Në këtë mënyrë morali i tyre ua lejoi atë që morali ynë nuk na e lejon, vjedhjen dhe plagjiturën (falsifikimin).

Kur kam studiuar periudhën e epokës së përkthimeve, pas një farë kohe studimi dhe hulumtimi arrita të zbuloj tri baza: Përkthimet perëndimore gjatë periudhës së rilindjes pra gjatë shekujve 14,15 dhe 16, përkthimi perëndimor që fillonte nga Italia deri në Amerikë ka qenë përkthim: Selektiv, falsifikues dhe fshehës.

Si ka qenë selektiv? Këta njerëz nuk kanë përkthyer libra që flasin për religjionin Islam, për letërsinë, apo libra që flasin për vlera, jo, ata përkthyen vetëm librat shkencorë, njohuritë mekanike, fizike, kiminë, matematikën, astronominë, inxhinierinë, mjekësinë, anatominë, bujqësinë, lundrimin etj. Këto libra kanë përkthyer, pra përkthim selektiv.

Gjithashtu përkthimi i tyre ka qenë falsifikues, sepse hoqën emrat e dijetarëve tanë dhe vendosën emrat e përkthyesve të tyre. Përveç disa autorëve që ishin me emër si Ibn Sina apo Ibn Rushd të cilët filluan të njiheshin me emrat Avi Cena apo Avarros, ndërsa librat e dijetarëve të tjerë u falsifikuan.

Gjithashtu ata përdorën përkthimin fshehës që do të thotë se kur ata ishin të detyruar të shkelnin vijat e kuqe (që ia kishin mveshur vetes) dhe të futeshin në njohuritë njerëzore që flasin për vlerat, këtë e bënin në fshetësi të madhe. Psh: Ata depërtuan në jurisprudencën Islame dhe morën transaksionet Islame dhe njohuritë e mirë administrimit. Gjithashtu morën disa vlera që nxisin në rregullimin shoqëror, por ata e fshehën këtë. Le të marim vetëm një shembull: A e dini se një pjesë e madhe e Kodit civil Francez është i marë nga Fikhu Maliki. Dhe libri mbi të cilin janë mbështetur (kanë përkthyer) quhet: "Sherh ed Derdijr ala metni Halil". Krahasimin mes këtij kanuni dhe fikhut Maliki e ka bërë një dijetar Egjiptian (Sejid Abdullah Husejn) në një studim të posaçëm duke e titulluar: "Krahasimet legjislative". Historiani i njohur Francez Gustave Le Bon në librin e tij "Qytetërimi Arab" thotë: Gjenerali më i njohur Francez, Napoleon Bonaparti, kur u kthye nga Egjipti për në vendlindjen e tij (Francë) në vitin 1801, mori me vete një libër që i përkiste jurisprudencës së shkollës Malikie (Malik bin Enes) i cili quhej: Sherh ed Edrdijr ala metni Halil. Kështu që Fikhu Maliki konsiderohet i pari fikh Islam që ka shoqëruar Oksidentin. Pra ka qenë përkthim: Selektiv, falsifikues dhe fshehës.

(www.kohaislame.com)

BESIMTARI PËRBALLË VËSHTIRËSIVE DHE SPROVAVE

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Allahu (xh.sh) thotë: "Vërtet, Ne e krijuam njeriun në vështirësi të njëpasnjëshme".[1],[2]. Duke parë tefsiret lidhur me këtë ajet me bëri shumë përshtypje komentimi i Imam Kurtubiut, i cili thotë: "Vështirësitë njeriut i fillojnë nga momenti kur i pritet kërthiza e deri në vdekje". Asnjë njeri në këtë botë nuk mundet t'i shpëtojë problemeve, telasheve, sprovave etj. Sprovat janë ligj i Zotit, ligj që nisi me Ademin (a.s) e do të mbarojë me besimtarin e fundit, që do të jetojë mbi sipërfaqen e tokës.

Ajo që i dallon njerëzit karshi sprovës është besimi. Kur besimtari sprovohet, ai duron, reflekton dhe lartësohet tek Zoti i gjithësisë. Kur jobesimtari sprovohet, shfryn mllef dhe inat ndaj Zotit, si dhe mallkon çdo gjë që është rreth tij. Kështu ai zhytet më shumë në stres dhe në sprovë.

Sprovimi në jetën e kësaj bote herë është me mirësi e rehati, e herë me fatkeqësi e vështirësi. Herë është me shëndet të plotë, e herë me sëmundje. Herë është me pasuri, e herë është me varfëri. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Njerëzit që janë sprovuar më së shumti në këtë botë janë Pejgamberët e Allahut, pastaj të ngjashmit me ta në devotshmëri...".[3]

1. Kur'ani, El-Beled: 4.
2. Vërtetë njeriun e kemi krijuar që të lodhet e të vuajë, për shkak të vështirësive që ai has në jetën e kësaj bote.
3. Transmetuar nga Ibn Maxheh dhe Imam Ahmedi.

Gjërat që na ndihmojnë për t'i tejkaluar vështirësitë dhe sprovat

Dijetarët kanë përmendur shumë punë të mira me të cilat njeriu mund t'i tejkalojë vështirësitë e jetës por ne do përmendim disa prej tyre:

1. NË KËTË BOTË NUK KA REHATI. Kjo botë është bota e sprovave, e vështirësive dhe padyshim se muslimanët do të sprovohen në të dhe do të kenë vështirësi në të. Sikurse ka thënë i Dërguari i Allahut: "Kjo botë është burg për besimtarin dhe xhenet për jobesimtarin".[4] Këtë hadith mund ta komentojmë në këtë mënyrë: Në krahasim me atë që e pret besimtarin në botën tjetër (në xhenet) kjo botë është burg, ndërsa në krahasim me atë që e pret jobesimtarin (në xhehenem) kjo botë është xhenet. Imam Ahmedin (Allahu e mëshiroftë) e kanë pyetur: "Kur do ta shijojë njeriu rehatinë?" Ai tha: "Kur ta vendosë këmbën e tij në xhenet!".[5]

2. BESIMI NË CAKTIMIN E ZOTIT (KADER). Duhet të jemi të bindur që ajo që na ka goditur ka qenë e shkruar prej Allahut. Besimi në kader është prej bazave të besimit në Allahun e Madhëruar. Pa të nuk pranohet besimi në Allahun e Lartësuar.

Imam Ebu Hanife lidhur me kaderin ka thënë: "Kaderi është sikurse dielli, nëse shikon tek ai të errësohen sytë, e nëse ja kthen shpinën ai (dielli) të ndriçon".

Nëse njeriu do që të kuptojë kaderin atëherë duhet t'i ketë të qarta tri gjëra:

A. Bindja në drejtësinë e Allahut. Të jemi të bindur se Allahu (xh.sh) nuk i bën padrejtësi askujt. Të jemi të bindur në drejtësinë absolute të Allahut të Madhëruar.

B. Bindja në urtësinë e Allahut. Allahu (xh.sh) vepron me urtësinë dhe me diturinë e Tij.[6]

C. Bindja në kufizimin e mendjes. Imam Shafiu ka thënë: "Shikimi dhe dëgjimi kanë kufizim".

3. MARRJA E GJËRAVE NGADALË ME MATURI DHE JO ME NXITIM. Kur të ndodhë një problem, mos nxito. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Maturia është prej Allahut, kurse nxitimi është prej shejtanit."[7] Transmetohet nga Ibn Abasi (r.a.) se, Pejgamberi (a.s.) i ka thënë Eshexh ibn Abdulkajsit: "Ti zotëron dy cilësi, të cilat Allahu (xh.sh.) i do pa masë: Sjelljen e butë dhe maturinë".[8]

4. KONSULTIMI ME NJERËZIT E MENÇUR DHE TË URTË. Allahu (xh.sh) i drejtohet profetit Muhammed (a.s), por njëkohësisht edhe gjithë besimtarëve me këto fjalë: "Konsultohu me ta për çështje të ndryshme..."[9]. Në këtë ajet shohim se si Allahu, e urdhëron të dërguarin e Tij që vazhdimisht të konsultohet me shokët e tij. Jo vetëm se ai ka pasur nevojë për konsultim, por edhe për t'i mësuar muslimanëve se konsultimi është cilësi e pandarë e besimtarit. Dijetarët kanë thënë: "Kush bën istihare, nuk pendohet dhe kush konsultohet nuk dështon".

5. Duaja/Lutja. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Duaja është arma e besimtarit".[10]

Sufjan ibn Ujejne (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Mos e lini lutjen, mos t'ju pengojë nga lutja ajo që ju e dini për vetën tuaj (për mangësitë që i keni), sepse Allahu i është përgjigjur lutjes së Iblisit edhe pse ai është krijesa me e keqe".[11]

Duaja është shkak për largimin e fatkeqësive, siç është edhe shkak për dhurimin e mirësive.

4. Transmetuar nga Muslimi.
5. El-Maksad El-Ershed, 2/398.

6. Për më shumë shih: Shembullin e Musait (a.s) me Hidrin në suren Kehf.
7. Transmetuar nga Tirmidhiu.
8. Transmetuar nga Muslimi.
9. Kur'ani, Ali Imran: 159.
10. Transmetuar nga Hakimi në El-Mustedrek.
11. Shuabul-Iman, 2/53.



GJASHTË VJET NGA NJË DITË E BEKUAR PËR SHKODRËN...

12 dhjetor 2014, ishte një ditë e bekuar, në të cilën përuruam me shumë gëzim xhaminë e "Dy Vajzave – Sara dhe Shehd", në vakëfin shekullor të Haxhi Shabanit, bamirësit të madh shkodran, emri i të cilit mbeti i lidhur pas bamirësisë, që i ruajti shembullin edhe shekuj më pas.

Sot, pas gjashtë viteve, teksa kthej kokën pas, ndjej një kënaqësi të madhe për këtë mirësi, që na u shkrua të jemi pjesë e saj; dikush me një fjalë, dikush me këmbënguljen për të kthyer në vend një vakëf të zaptuar, dikush me interesimin e vazhdueshëm për arritjen e koordinimit me donatorin, dikush me pasurinë e tij dhe gjurmën e vlerësuar e të dëshmuar, dikush e shumëkush, me aq sa i ishte shkruar të kishte hise shërbimi e angazhimi për arritjen e kësaj dite shendi të rrënjosur në memorien tonë komunitare.

Sot, xhamia e "Dy Vajzave" është pa dyshim një xhami që e ka krijuar profilin dhe emrin e saj, kjo edhe falë përkushtimit të imamit, muezinit dhe besimtarëve frekuentues të saj, por jo vetëm.

Pas miratimit të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe mbështetjes së vazhdueshme, si dhe falë bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam në Tiranë, sot, kjo xhami tregohet me gisht për aktivitetin e saj, cilësinë e tij, si dhe kthimin në një qendër islame të dashur për krejt brezat frekuentues të saj.

Në këtë kontekst, më duhet të shpreh falënderimet më të përzemërta dhe mirënjohjen më të thellë për krejt ata burra të përkushtuar, që u bënë shkak, që sot të kemi këtë bekim për komunitetin, Shkodrën e shtrenjtë dhe krejt besimtarët.

Në krye të herës, mikun e vjetër dhe dashamirin e Shkodrës, Prof. As. Dr. Ramiz Zekaj, i cili trokiti një ditë ne derën e Myftinisë Shkodër për një projekt, që nuk kishte nevojë për t'u diskutuar, as kohë për të humbur drejt realizimit të tij. Dy vakëfet më të përshtatshme për të, ishin të dy të zaptuar e të pa plotësuar në dokumentacion. Falë përpjekjes sonë institucionale, u realizua lirimi i një pjese të vakëfit të Shaban Efendisë, ku edhe nisën punimet për xhaminë e re, falë edhe bashkëpunimit me Bashkinë e Shkodrës dhe institucionet lokale, ku nuk mungoi gatishmëria për të bërë më të mirën e mundur, Allahu i shpërbleftë!

Jam dëshmitar i gëzimit që na kaploi atë ditë, bashkë me të nderuarin Dr. Zekaj, kur prindi i njërës prej "Dy Vajzave", durimtari zemërmirë, inxh. Ahmed Esh-Shaia, në emër të donatorëve, dha pëlqimin e tij për vendin dhe detajet e tjera të realizimit të këtij projekti me vlerë të madhe për komunitetin e qytetin tonë.

Allahu i Madhëruar ia shpërbleftë me mirësitë e Tij dhe e bëftë këtë vepër, dëshmi të madhe të besimit dhe të përkushtimit në peshoren e veprave të tyre të mira në ditën e gjykimit.

Nga ana tjetër, më duhet të shpreh falënderime të përzemërta për teologun Lavdrim Hamja, imamin e nderuar të kësaj xhamie; për muezinin e saj, Haxhi Rexhep Osja, për mirëmbajtësin vullnetar të lulishtes dhe ambienteve rrethuese të xhamisë së "Dy Vajzave", të palodhurin prof. Xhevat Kuçi, për pjestarët e këshillit të xhamisë, për mbështetësit e projekteve dhe aktiviteteve të saj, si dhe për krejt frekuentuesit e saj, që e mbajnë në gjallëri, falë përkushtimit të tyre.

Allahu i Madhëruar i begatoftë muslimanët e Shkodrës dhe krejt qytetarët e saj, i ruajt nga çdo e keqe dhe i gëzoftë me mëshirën dhe mirësitë e Tij; na ktheftë nga dyert e bamirësisë, mirëkuptimit e harmonisë, na udhëzoftë përherë drejt hapësirave të pakufishme të dashnisë së Tij, për ta marrë e për ta përhapur kudo, me sa të kemi mundësi, për të mirën e qytetit e krejt vendit, në rrugën e dëshmimit si të dashurit e Zotit Një!

Bekime e mirësi!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 12 dhjetor 2020

MOS E HUMB SHPRESËN NË UDHËZIMIN E ASKUJT!

"Umer ibnul-Hattabi (r.a) ishte nisur rrugës për të vrarë Pejgamberin (a.s); tashmë ai është i varrosur pranë tij! Mos e humb shpresën në udhëzimin e askujt, sepse Allahu udhëzon kë të dojë!"

Dr. Ahmed I. El-Misaravi

AZERBAJXHANI
OSE REPUBLIKA E AZERBAJXHANIT

Azerbajxhani, ose Republika e Azerbajxhanit, është një shtet në rajonin e Kaukazit. Ky vend ndodhet në pikëtakimin mes Evropës Lindore dhe Azisë Perëndimore, dhe kufizohet nga Deti Kaspik në lindje, Dagestani në veri, Gjeorgjia në veriperëndim, Armenia e Turqia në perëndim (të enklavës azere Nahxhevān), dhe nga Irani në jug. Azerbajxhani ka një sipërfaqe prej 86 600 km² [1] , dhe një popullsi prej 10,184,580 banorësh (Dhjetor, 2020).[2]

Baku është kryeqyteti i vendit.

Sipas burimeve historike, në kohërat antike kjo zonë ka pasur emërtime të ndryshme, si: Andirpatian, Atropatena, Adirbixhan, Azirbixhan, dhe në fund, Azerbajxhan.

NATYRA GJEOGRAFIKE E AZERBAJXHANIT

Në gjeografinë e Azerbajxhanit mbizotërojnë tri karakteristika kryesore: Deti Kaspik, bregu i të cilit formon një kufi natyror në lindje, vargmali i Kaukazit të Madh në veri, dhe zonat e gjera të rrafshëta në qendër të vendit. Ekzistojnë gjithashtu tre vargmale, Kaukazi i Madh dhe i Vogël, dhe Malet Talysh, që së bashku mbulojnë afërsisht 40% të vendit. Maja më e lartë e Azerbajxhanit është mali Bazardüzü (4,466 m), ndërsa pika më e ulët e vendit shtrihet në Detin Kaspik (−28 m).

Pothuajse gjysma e të gjithë vullkaneve të baltës në Tokë janë përqendruar në Azerbajxhan; këto vullkane ishin gjithashtu midis të nominuarve për "7 Mrekullitë e Reja të Natyrës" (New 7 Wonders of Natyre).

Burimet kryesore të ujit në Azerbajxhan përfaqësohen nga ujërat sipërfaqësore. Sidoqoftë, vetëm 24 nga 8,350 lumenj, janë më të gjatë se 100 km. Të gjithë lumenjtë e Azerbajxhanit derdhen në Detin Kaspik, në lindje të vendit. Liqeni më i madh është Sarisu (67 km2), dhe lumi më i gjatë është lumi Kur (1,515 km), i cili është një lumë ndërkufitar me Armeninë. Azerbajxhani ka disa ishuj përgjatë detit Kaspik, të vendosura kryesisht në Arkipelagun e Baku-së.[3]

KLIMA

Azerbajxhani qendror dhe lindor karakterizohen nga një dimër i butë, dhe një verë e gjatë dhe shumë e nxehtë, me temperatura mesatare rreth 27 ° C, dhe me temperaturat maksimale që arrijnë në 43 ° C. Azerbajxhani Juglindor karakterizohet nga një klimë subtropikale e lagësht, me reshjet më të larta në vend (me rreth 1,200 deri në 1,400 milimetra në vit), shumica e të cilave bien në muajt e ftohtë.

Një klimë e thatë kontinentale, me një dimër të ftohtë dhe një verë të thatë e të nxehtë, mbizotëron në Nahxhevān, në lartësitë 2,300 deri në 3,300 metra. Llojet e klimës mesatarisht të ngrohtë, të thatë ose të lagësht, mund të gjenden në pjesë të tjera të Azerbajxhanit. Zona

pyjore malore e vendit, ka një klimë mesatarisht të ftohtë, ndërsa klima e tundrës së lartë karakterizon lartësitë prej 10,000 metrash e më lart. Ngricat dhe reshjet e mëdha të borës i bëjnë kalimet në lartësi të tilla, të paarritshme, për tre ose katër muaj të vitit.[4]

GJUHA

Gjuha zyrtare është gjuha azerebajxhane, e cila i përket familjes së gjuhëve turke, dhe flitet nga afërsisht 92% e popullsisë së vendit si gjuhë amtare. Rusishtja dhe Armenishtja (vetëm në Nagorni-Karabak) fliten gjithashtu, nga rreth 1.5% e popullsisë. Në vend ekzistojnë gjithashtu një duzinë gjuhësh të tjera, si gjuhët Avar, Budukh, Gjeorgjiane, Udi , etj, që fliten nga minoritetet e tjera.[5]

FEJA

Azerbajxhani është një vend post-komunist ku feja ishte e ndaluar, por rreth 97% e popullsisë së tij janë myslimanë, kurse rreth 3% janë të krishterë (kryesisht ortodoksë dhe apostolikë armenë, rusë dhe gjeorgjianë). Sipas nenit 48 të Kushtetutës së tij, Azerbajxhani është një shtet sekular, dhe siguron lirinë fetare.

EKONOMIA

Nafta mbetet produkti më me rëndësi për ekonominë e Azerbajxhanit, së bashku me pambukun, gazin natyror dhe produkte bujqësore. Në Azerbajxhan, njerëzit vizitojnë "llixhat e naftës", për t'u larë në naftën e papërpunuar lokale, në Naftalan.

Nga një prodhues dhe eksportues kryesor i havjarit në të kaluarën, industria e peshkimit të Azerbajxhanit sot është e përqendruar në rezervat që po pakësohen çdo ditë të peshkut të blinit, në Detin Kaspik.

Azerbajxhani ka pellgun më të madh bujqësor në rajon. Rreth 54.9 përqind e Azerbajxhanit janë toka bujqësore. Institutet e kërkimit shkencor bujqësor të Azerbajxhanit janë përqendruar kryesisht në livadhet dhe kullotat, në kopshtari dhe në kulturat subtropikale, tek perimet me gjethe të gjelbra, vreshtaria, pambuku dhe bimët mjekësore. Në disa toka të vendit, është fitimprurëse rritja e drithërave, patateve, panxharit të sheqerit, pambukut, etj. Blegtoria dhe produktet e qumështit janë gjithashtu produkte të rëndësishme bujqësore në Azerbajxhan.[6]

HISTORI

Territori i Azerbajxhanit është jashtëzakonisht i pasur me monumente arkeologjike, që provojnë se ky rajon është një ndër vendbanimet më të vjetra në botë të banuara nga njeriu.

Në mijëvjeçarin e parë, para Isait (a.s), dhe në fillimin e mijëvjeçarit të parë të erës sonë, në tokat e Azerbajxhanit ekzistonin shtete të tilla të fuqishme si Mana, Mbretëria Skitiane, Atropatena dhe Albania Kaukaziane. Këto shtete luajtën një rol të rëndësishëm në përmirësimin e mëtejshëm të kulturës së administrimit publik në Azerbajxhan, në historinë ekonomike dhe kulturore të vendit, si dhe në formimin e një kombi të vetëm.

Në shekullin e 3-të erës sonë, Azerbajxhani u pushtua nga Perandoria Sasanido-Iraniane, kurse në shekullin e 7-të, vendi hyri nën Kalifatin Islam. Këto perandori që hynë në Azerbajxhan, sollën me vete një popullsi të madhe me origjinë iraniane edhe arabe.

Në shekujt e parë të erës sonë, etnitë turke, të cilat përbënin shumicën e popullsisë së vendit, dhe të cilat ishin më të forta dhe më të organizuara ushtarakisht e politikisht, luajtën një rol të rëndësishëm në procesin e formimit të një kombi të vetëm. Në mesin e atyre grupeve etnike turke, turqit Oguzë ishin ata që dominonin. Gjatë kësaj periudhe, turqishtja u bë gjuha kryesore e komunikimit midis popujve dhe grupeve etnike që jetonin në territorin e Azerbajxhanit, duke bërë kështu që kjo gjuhë të luante një rol mjaft të rëndësishëm për unifikimin mes veriut dhe jugut, dhe për formimin e një kombi të vetëm. Për sa i përket besimit

Baku, kryeqyteti i Azerbajxhanit

fetar, gjatë shekujve të parë të erës sonë, në Azerbajxhan ekzistonin besime të ndryshme si zoroastrizmi, adhurimi i zjarrit, diellit, hënës, qiellit, yjeve, tokës, ujit, etj... kurse adhurimi i Zotit, hyjnisë kryesore të turqve të lashtë, ende nuk i kishte shtypur plotësisht besimet e tjera fetare. Në veri të vendit, në disa pjesë të shtetit të Albanisë kaukaziane, kryesisht në rajonet malore perëndimore të saj, po përhapej krishterimi.

Me ardhjen e Islamit në shekullin e 7-të të erës sonë, Azerbajxhani do të bënte një ndryshim rrënjësor historik. Islami i dha një shtysë të fortë formimit të një kombi të vetëm në Azerbajxhan. Kjo fe e re solli unitetin fetar midis grupeve etnike turke dhe joturke në vend, dhe formimin e traditave të përbashkëta, në të gjithë territorin e Azerbajxhanit. Marrëdhëniet farefisnore u zgjeruan dhe procesi i bashkimit kombëtar nën një flamur të vetëm turko-islam, kundër Perandorisë Bizantine dhe zotërve të saj feudalë armenë dhe gjeorgjianë, të cilët u përpoqën ta vinin të gjithë Kaukazin e Jugut nën ndikimin e krishterimit, u thellua edhe më tej.[7]

Vullkane balte

ISLAMI NË AZERBAJXHAN

Pas stabilizimit të Islamit në Gadishullin Arabik, Kalifët e Drejtë pas Profetit (a.s), i hodhën sytë për përhapjen e Islamit drejt vendeve të Shamit, Irakut, e Afrikës së veriut, dhe më pas, drejt Azisë dhe Anadollit. Këto do të ishin veprime të domosdoshme në shërbim të përhapjes së fesë së Zotit, si edhe për të mbrojtur fitoret që ishin realizuar tashmë. Azisa Qendrore dhe Kaukazi, përfaqësonin shtrirjen natyrore dhe thellësitë gjeografike të zgjerimit të mëtejshëm të Islamit.

Sidoqoftë, ekzistonin edhe disa faktorë të tjerë themelorë, që e bënin marrjen e Azerbajxhanit nga muslimanët, një gjë shumë më të rëndësishme dhe më të pashmangshme sesa disa rajone të tjera, për ta.

Rajonet e Azerbajxhanit dhe të Armenisë, ishin ndër vendet të cilat myslimanët e kishin planifikuar të hynin në to, sidomos pas suksesit të njëpasnjëshëm në betejat El-Bueib, El-Xhisr, El-Sekātíje, El-Kādisíje dhe Nehāvend, më e madhja e të cilave ishte beteja e El-Kādisíjes, pastaj e Nehāvend-it, që u zhvilluan për marrjen e Irakut dhe të Persisë. Këto beteja ishin drejtuar nga sahabët e shquar Halid ibn El-Velíd, Ebu Ubejd Eth-Thekafíj, El-Muthenna ibn El-Hārithe, dhe Se'ad ibn Ebi El-Vekās - Allahu qoftë i kënaqur nga ata të gjithë! Më pas, këta komandantë të shquar, kishin ndërtuar baza urbane dhe ushtarake në ato vende, të tilla si Kufja, Basra, etj.

Në ato kohëra, Azerbajxhani ishte më gjithëpërfshirës dhe më i gjerë se republika aktuale e Azerbajxhanit, pasi

12

brenda tij përfshinte provinca të Iranit Verior, Republikën e Azerbajxhanit, Republikën Armene dhe rajonet e skajshme lindore të Turqisë, deri në Liqenin Van. Këto zona karakterizohen nga male të larta, nga moti dimëror me shira të shumta dhe me borë, si dhe nga bollëku i lumenjve, më të rëndësishmit prej të cilëve janë lumi Er-Rass dhe lumi El-Kur.

Myslimanët e dinin se këto zona të gjera ishin një nga fortesat dhe qendrat kryesore të fesë Zoroastriane. Madje, atje ishte vendlindja e themeluesit të kësaj feje, Zaradeshtit (Zoroasterit), dhe ky vend përmbante një numër të madh të tempujve të shenjtë të persianëve, gjë që e bëri atë zonë strehën e shumicës së persianëve, azerbajxhanasve dhe armenëve që kishin marrë arratinë për të ikur sa më larg ushtrive islame, pas humbjeve të tyre në Irak dhe Persi. Kështu që, përveç pozitës së lartë fetare që gëzonte ky rajon, tashmë ishte kthyer edhe në një qendër strehimi për të arratisurit, të cilët përbënin një rrezik kundër forcave myslimane të vendosura në jug.

Në fakt, në betejat e Irakut, myslimanët ishin befasuar nga pjesëmarrja e armenëve dhe azerbajxhanasve në to. Në betejën e rëndësishme të Kādisijes (viti 15 h / 636 e.j), kishin ardhur një numër i madh i tyre në mbështetje të persianëve. Gjithashtu edhe në Betejën e Jermūk-ut, që u zhvillua në të njëjtin vit në frontin e vendeve të Shamit, një numër i madh i azerëve dhe i armenëve kishin ardhur në mbështetje të bizantinëve, e po ashtu edhe në Betejën e Nehāvend-it, në Persi (viti 21 h/ 641 e.j). Përkundër këtyre përpjekjeve të dëshpëruara të armenëve dhe azerbajxhanasve për t'u bashkuar herë me persët e herë me bizantinët, dhe për t'u ardhur në ndihmë atyre kundër forcave Islame, gjithsesi, beteja e Nehāvend -it në veçanti, e cila e theu fuqinë persiane, kishte hapur tashmë rrugën për eliminimin e forcave mbështetëse të tyre, respektivisht, të forcave armene dhe atyre azere.

Kur sundimtari i Azerbajxhanit, Isfendijāri, pa përparimin e forcave myslimane drejt tij, ai menjëherë filloi të mblidhte radhët e ushtarëve të tij në një numër të madh, dhe u përpoq t'ua priste rrugën forcave myslimane që po vinin të udhëhequr nga Neím ibn Mukrin. Të dyja palët u takuan në një vend të quajtur Vāxh Reudh, e cila është një zonë fushore e vendosur midis zonave Hemedhān dhe Ed-Dínur. Plani i udhëheqësit të azerbajxhanasve ishte të fshihej në rrugë, dhe t'i kapte në befasi myslimanët, por komandanti mysliman Neím ibn Mukrin, e kishte marrë vesh që herët lajmin për komplotin e tij.

Historiani Et-Taberiu, thotë: "Ai së bashku me njerëzit e tij dolën në marshim, derisa mbërritën në Vāxh Reudh, dhe aty u zhvillua një betejë e ashpër, po aq e ashpër sa në Nehāvend. Pati një numër të madh të vrarësh, sa nuk numëroheshin. Ishte një betejë vërtetë e madhe! Myslimanët i kishin shkruar edhe Omerit (r.a) për ngjarjen. Omeri (r.a) ndjeu një farë frike për ta, dhe tregoi interes të madh, e po priste se çfarë lajmi do t'i vinte prej tyre. Dhe vërtetë, lajmi i mirë i erdhi. Kur i kishte ardhur lajmëtari, Omeri (r.a) i kishte thënë: "Përgëzimi?" Lajmëtari i kishte thënë: "Jam Urveja." Pasi e kishte përshëndetur, Omeri i kishte thënë: "Na solle ndonjë lajm përgëzimi?" E ai i ishte përgjigjur: " Po, po, përgëzimi!" Omeri i kishte thënë: "Lajmëtari i (komandant) Neímit je ti?" –Po, - i kishte thënë ai. – E çfarë lajmi na sjell?- e kishte pyetur Omeri (r.a). – Kam lajmin e mirë të fitores.-i kishte thënë ai, dhe e kishte lajmëruar për gjithçka. Omeri kishte falënderuar Allahun, dhe kishte urdhëruar që letra me atë lajm të lexohej para njerëzve; edhe ata kishin falënderuar Allahun për këtë."[8]

Pas kësaj fitoreje që u arrit në Vāxh Reudh, myslimanët hartuan një plan për t'i rrethuar rajonet e Azerbajxhanit nga dy fronte, në mënyrë që këto zona të ashpra dhe të mëdha të gjendeshin midis "dy nofullave të pincës". Kështu që dy ushtri të myslimanëve u nisën drejt atyre dy fronteve: e para e udhëhequr nga Bekír ibn Abdullah, u nis drejt jugut të Azerbajxhanit, dhe në ato zona Bekíri (r.a) dhe forcat e tij kishin hasur në xhepat e rezistencës persiane. Në fakt, kishte qenë një rezistencë e ashpër dhe e dhunshme, të cilën ai kishte arritur ta mposhtte. Pas kësaj, ai ishte kthyer drejt Erdabíl-it, që ishte kryeqyteti i Azerbajxhanit në atë kohë.

Kurse ushtria e dytë, po vinte nga fronti i vendeve të Shamit e udhëhequr nga Utbe ibn Ferkad, i cili ishte një sahabij i shquar. Utbe dhe ushtria e tij arritën të depërtonin në fshatrat dhe qytetet jugperëndimore të Azerbajxhanit, dhe të mposhtnin një ushtri azerbajxhanase të udhëhequr nga Behrām ibn Farokhzād, që ishte vëllai i udhëheqësit të Azerbajxhanit, Isfendijār-it, dhe të cilin myslimanët e kishin kapur rob edhe më parë, në betejën e Vāxh Reudh. Utbe arriti ta zmbrapste këtë grupacion azerbajxhanas dhe të vazhdonte marshimin e tij drejt kryeqytetit Erdabil.

Dhe vërtetë, dy ushtritë, ajo islame



Xhamia "Xhuma" në Shamakh, Azerbajxhan

dhe ajo azere, u takuan pranë Erdabíl-it ku u zhvillua një betejë e ashpër. Komanda e Përgjithshme për ushtritë myslimane iu dorëzua sahabiut Utbe ibn Ferkad (r.a). Forcat myslimane arritën të fitonin dhe të hynin në Erdabíl. Ata e lanë të lirë satrapin (titull i dikurshëm persian) e Azerbajxhanit, i cili kishte qenë njëri nga udhëheqësit e lartë që ishin burgosur nga Isfendijāri. Myslimanët nënshkruan me të një marrëveshje paqeje, ku ai dhe populli i tij do të tregonin bindje ndaj myslimanëve dhe do t'u paguanin xhizjen atyre, ndërsa myslimanët do t'u siguronin mbrojtje atij dhe popullit të tij.

Dokumenti i kësaj marrëveshjeje ekziston akoma edhe sot i ruajtur në Muzeun e Historisë, në Baku, në kryeqytetin aktual të Azerbajxhanit, dhe aty thuhet:

"Në emër të Zotit, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Kjo është çfarë Utbe ibn Ferkad, nëpunësi i Omer ibn El-Khattab, Prijësit të Besimtarëve, u dha popullit të Azerbajxhanit: Fushat e vendit, malet, skajet dhe brigjet e tij, edhe ndjekësit e feve të ndryshme në vend, të gjithëve atyre u jepet siguria për veten e tyre, pasurinë, fenë dhe legjislacionet e tyre, me kushtin që ata të paguajnë xhizjen, aq sa kanë mundësi, gjë të cilën nuk e ka detyrë fëmija, as gruaja, as nuk është detyrë në kohën kur njeriu s'ka asgjë në dorë nga pasuria e kësaj dynjaje, as njerëzit që qëndrojnë vetëm në tempuj duke u marrë me adhurime dhe që nuk kanë në dorë asgjë nga pasuritë e kësaj bote. Këtë të drejtë e kanë ata, edhe ata që banojnë me ta, kurse kanë detyrë ta akomodojnë për një ditë dhe një natë myslimanin që është ushtar i ushtrisë së myslimanëve, edhe ta njoftojnë atë për çfarë i pyet. Ata të cilët largohen në ndonjë vit nga vendi, ata nuk e kanë detyrë të paguajnë atë vit, kurse kush vjen dhe qëndron në këtë vend, ka detyrim si ata që banojnë aty; e kush del në udhëtim, është i mbrojtur derisa të hyjë në strehën e tij."[9]

Forcat myslimane filluan të depërtojnë në rajone të tjera të Azerbajxhanit. Stabiliteti i myslimanëve dhe suksesi i tyre në marrjen e Azerbajxhanit kishte shkaktuar zemërimin e armenëve, khazarëve dhe banorëve të tjerë të Kaukazit. Është e vërtetë se forcat islame gjatë gjithë epokës së Omer ibn El-Khattāb, edhe pas tij, në kohën e Othmān ibn Affān - Zoti qoftë i kënaqur prej tyre - nuk pushuan së sulmuari këto zona, dhe të depërtonin në to. Fushata më e njohur, në fillimet e epokës së Othmanit, ishte ajo nën udhëheqjen e Selmān ibn Rabía. Kështu që armenët, khazaret, kaukazianët edhe bizantinët, u bashkuan dhe forcat e tyre u mblodhën në qytetin armen Shemshat, në perëndim të Azerbajxhanit, me qëllim për t'i sulmuar myslimanët në Azerbajxhan.

Maiden Tower
Baku, Azerbaijan

Guvernatori i Kufes, El-Velíd ibn Ukbe ibn Muaít, ishte përgjegjësi kryesor dhe guvernatori i rajoneve të Irakut, Iranit dhe Azerbajxhanit asokohe. Ai i kërkoi komandantit të ushtrisë së tij, Mesleme ibn Habíb, të dilte për t'u përballur me këtë aleancë bizantine-armene-kaukaziane-khazariane, e cila përfaqësonte një kërcënim serioz për ta, dhe e mbështeti me gjashtë mijë luftëtarë. Mesleme ibn Habíb doli vërtetë, dhe arriti të nënshtronte qytetet më të rëndësishme përgjatë rrugës së tij, të tillë si qytetin e Tbilisit, dhe më pas qytetin Akhlāt që ndodhet në skajin më të largët verior të Turqisë së sotme. Kalifi i Drejtë, Othman ibn Affān (r.a), lëshoi një dekret me anë të të cilit e emëronte El-Esh'ath ibn Kajs El-Kindi si guvernator të Azerbajxhanit.

Kur kalifati kaloi tek Ali ibn Ebi Tālib (r.a) (35-40 h / 656-661e.j), ai e konfirmoi sërish mandatin e El-Esh'ath ibn Kajs El-Kindi mbi Azerbajxhanin, i cili kishte qenë një nga guvernatorët më aktivë në përhapjen e Islamit në ato vise. Kështu që, në periudhën kur ai sundoi atje, Azerbajxhani u bë një vend krejtësisht Islam, ku u përhap mësimi i Kur'anit Fisnik, gjuha arabe dhe shkencat e tjera islame. Përveç kësaj, El-Esh'ath solli atje arabë, dhe i vendosi të banonin në Erdabíl, kryeqytetin e Azerbajxhanit. Pak para përfundimit të mandatit të tij në Azerbajxhan, një numër i madh i arabëve dolën nga qytetet e Basrës dhe të Kufes, dhe u vendosën në Azerbajxhan, e që më pas u përhapën në shumë anë të vendit. Ata blenë toka atje e i përmirësuan ato, dhe fshatrat azerbajxhanase kërkonin mbështetjen e tyre, për mbrojtje dhe kujdesim.

Kjo është historia e zgjerimit të Islamit në Azerjbajxhan dhe Armeni, proces i cili zgjati dy dekada. Deri më sot, shumë rajone të Azerbajxhanit mbajnë ende emra arabë, si fshatrat: Arab, Arab Kadím, Arab Shelbāsh, si edhe nëntë rajone të tjera që janë të gjitha arabe, të tilla si rajoni Sadabād, fshati Arab Bāl Oglāni, etj. Pas epokës së Kalifëve të Drejtë, kur Islami zuri vend në ato rajone, Umejadët filluan rindërtimin e Azerbajxhanit. Xhamia Umejade, në rajonin Shamakhi, si edhe Mesxhidi i Xhumasë, qëndrojnë akoma edhe sot si dy dëshmi të asaj pranie të lashtë Islame në rajonin e gjerë të Azerbajxhanit.[10]

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

1. https://azerbaijan.az/
2. https://www.worldometers.info/world-population/azerbaijan-population
3. https://en.wikipedia.org/wiki/Azerbaijan#Geography
4. https://www.britannica.com/place/Azerbaijan#ref44280
5. https://en.wikipedia.org/wiki/Azerbaijan#Languages
6. https://en.wikipedia.org/wiki/Economy_of_Azerbaijan
7. https://azerbaijan.az/information/301
8. Tārikh Et-Taberij, 4/148
9. Shejkhu Muham'med El-Khuderij, Itmām el-vefā fi Sīret El-Hulefā, fq.90
10. https://www.aljazeera.net/midan/intellect/history/

MYFTIU PRITI DREJTORIN E FONDACIONIT "MIRËSIA"

Ditën e mërkurë, më 2 dhjetor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, z. Korab Kaja, drejtor i Fondacionit "Mirësia".

Gjatë takimit të përzemërt, u diskutua rreth disa projekteve bamirëse, që Myftinia Shkodër ka në bashkëpunim me Fondacionin "Mirësia", duke konfirmuar vullnetin e mirë të bashkëpunimit për të mirën e komunitetit.

Me mbarësinë e Allahut, do të nisë puna për ndërtimin e një qendre të re kulturore, si pjesë e angazhimit të Myftinisë Shkodër për pajisjen e xhamive kryesore me qendra kulturore që i shërbejnë komunitetit të besimtarëve dhe më gjerë.

Prej vitesh, Fondacioni "Mirësia" ka kontribuuar për ndërtimin e shumë

xhamive, qendrave kulturore, shtëpive të banimit dhe ka mbështetur me ndihma të llojllojshme komunitete të shumta në nevojë.

Për këtë, Myftinia Shkodër ka shprehur mirënjohjen e saj për këto vepra të vlefshme që kanë gjallëruar jetën e komuniteteve ku janë zbatuar.

MYFTIU: "ÇËSHTJA E PRONAVE, PRIORITET I ABUZUAR!"

Paraditën e së hënës, më 21 dhjetor 2020, Myftiu i Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me stafin e Myftinisë, ku u diskutua për aktivitetin dhe problematikat e kohëve të këtij viti, ku si pasojë e situatës së krijuar pas shfaqjes së pandemisë, shumë objektiva dhe aktivitete mbetën në letër.

Myftiu theksoi se çështja e pronave është prioritet i abuzuar, ku Myftinia Shkodër, përtej përpjekjeve të saj, është penalizuar nga mungesa e vullnetit dhe stërzgjatja e procesit të kthimit dhe regjistrimit të pronave të saj, si dhe si pasojë e keqmenaxhimit të tyre për shumë arsye, shpesh edhe joobjektive.

Myftiu dëgjoi relacionet e përgjegjësve të sektorëve të ndryshëm, sidomos atij të pronave, thirrjes islame dhe medias, ku u vu në dukje përpjekja dhe angazhimi për të bërë më të mirën në shërbim të vlerave universale të Thirrjes Islame, ruajtjes së dinjitetit dhe përfaqësimit sa më dinjitoz në rang lokal, kombëtar e përtej.

Myftiu falënderoi stafin e tij edhe për mbështetjen në sprovën e tij shëndetësore dhe u lut që e mira dhe begatia të përfshijë të gjithë besimtarët e mbarë njerëzimin dhe kjo situatë, shpesh kontradiktore e paradoksale, me të cilën po përballet njerëzimi, të kalojë sa më shpejt, pa dëme.

"MË E MIRA PËRGATITJE ËSHTË PËRKUSHTIMI...", LIGJËRATË NË XHAMINË E MES-MYSELIMIT

Ditën e hënë, më 21 dhjetor 2020, pas namazit të akshamit, teologu Lavdrim Hamja mbajti një ligjëratë me temë "Më e mira përgatitje është përkushtimi..." në xhaminë e Mes-Myselimit.

Në prani të besimtarëve, që kishin ardhur për të dëgjuar ligjëratën, teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave", foli rreth kuptimit të përkushtimit përmes adhurimeve. Përmes ajeteve kur'anore, haditheve të Pejgamberit (a.s) dhe shembujve të ndryshëm u ndal tek rëndësia e përkushtimit, ku besimtari mysliman, përmes kryerjes së adhurimeve të ndryshme, e përkthen këtë përkushtim në moral të bukur, sjellje të mirë, vepër shembullore dhe fjalë me vlerë e dobi.

Ai theksoi, se përkushtimi i myslimanit nuk vihet re shumë në adhurimet e detyrueshme, si namazi, agjërimi, haxhi apo zekati, por ai shfaqet qartë në faljen, tolerimin, ndihmën dhe dhembshurinë që besimtari u dhuron të tjerëve, kushdo qofshin ata, të afërm apo të largët.

NË RAHMET TË ALLAHUT, ERUDITI ISLAM H. ISMAIL MUÇEJ



Ditën e hënë, më 14 dhjetor 2020, kaloi nga kjo botë kalimtare studiuesi dhe eruditi i shquar islam, H. Ismail Muçej.

Kryeredaktori i parë i gazetës "Drita Islame", organ mediatik i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, si dhe kontribuues i çmuar i shtypit islam, para dhe pas çlirimit të vendit nga diktatura komuniste.

Sikurse shkruan edhe z. Islam Dizdari, H. Ismail Muçej "lindi më 14.12.1924 në Shkodër. Jeta e këtij burri është plot kthesa dhe të papritura të mundimshme. Bie e ngrihet, e ka të vështirë, por nuk dorëzohet, nuk thyhet, vazhdon e ecën gjithnjë përpara. Ndoqi studimet në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës ku u shqua si nxënës i shkëlqyeshëm. Që në bankat e shkollës përvetësoi mjaft mirë arabishten, anglishten, frëngjishten dhe italishten. Falë kësaj përgatitjeje iu sigurua bursa për në Institutin Oriental të Napolit. Por kjo nuk u arrit. Shkaqet nuk po i përmendim. Janë politike.

Si medresist mori pjesë në shumë veprimtari atdhetare kundër pushtuesit, më vonë u aktivizua në organizatën e Ballit Kombëtar, madje kontribuoi në themelimin e çetave në Pukë e në Kukës dhe kreu detyrën e përkthyesit pranë misionit anglez në veri të Shqipërisë. U lidh dhe bashkëpunoi me nxënës të shumë shkollave të vendeve të huaja, si: Belgjikë, Itali, Turqi, Indi etj., me të cilët shkëmbente literaturë historike, letrare, fetare e shkencore. Iu përkushtua publicistikës duke qenë bashkëpunëtor i rregullt i revistës "Zani i Naltë" "Kultura Islame" dhe "Njeriu". Që krejt i ri, pa i mbushur të njëzetat replikoi plot kompetencë me njërën nga gazetat e njohura shtetërore të asaj kohe (1944) "Bashkimi i Kombit"...

Më 6.11.1952 arrestohet, ku në fillim dënohet me vdekje që iu kthye në burgim me 20 vjet. Akuzat nuk po i përmendim, ato janë falsifikime të qëllimta të një prokurorie ogurzezë. Këto akuza u përsëritën me qindra herë ndaj burrave të nderuar të kombit tonë, ndaj ajkës së inteligjencës së vendit tonë, ndaj të moshuarve dhe të rinjve. Sundonte injoranca, egërsia, që aq mirë e kemi njohur, sundonte lufta e klasave. Pas viteve sfilitëse në punët e rënda të kampeve famëkeqe, tani ndryhet në burgun famëkeq të Burrelit. Këtu zotëri Ismaili kaloi ditët e gjata të pjesës më të bukur të rinisë së tij. Burgu qe një shkollë e vërtetë, një vatër me shumë vlera edukimi, burrërie.

Në ato vrima të zeza të birucave të burgut ku diktatura i kishte ndryrë bijtë më të mirë të popullit për t'i thyer, aty u rritën dhe u edukuan heronj të vërtetë. Sikurse kujton vetë zotëri Ismaili: "... ishte ai mjedis, ajo frymë kulture e pjekurie që t'i largonte vuajtjet fizike e brengat shpirtërore dhe e mbante njeriun me shpresa se nuk ka mbaruar gjithçka... Aty gjeta mësuesin e fundit të jetës sime, edukatorin e shquar në të gjitha fushat e kulturës që mbeti për mua si edukator dhe dekan i universitetit të jetës. Ky ishte eruditi Et'hem Haxhiademi, nga Elbasani..."

Veprat që shkroi janë shembulli më i qartë se deri ku arrin vullneti dhe këmbëngulja e njeriut, këto vepra as një institut i organizuar nuk do të mund t'i realizonte, e pra i vetëm pa ndihmën e askujt ai i hartoi dhe më në fund i bëri gati për botim. Por, e them me dhimbje, ato janë ende në dorëshkrim. Ja të japim një panoramë të shpejtë të tyre:

- ***Fjalori Arabisht-Shqip*** me 45.000 fjalë dhe 20.000 shprehje prej 2.000 faqesh.
- ***Fjalori Shqip-Arabisht*** me 25.000 fjalë dhe 30.000 shprehje prej 1300 faqesh.
- ***Metodë e mësimit të gjuhës arabe***, e përkthyer nga Gaspary Otto Sauer, orientalist i shquar gjerman.
- ***Feja dhe misioni i saj***, me 350 faqe.
- ***Pse përqafova Islamin***, 120 faqe.
- ***Pohime të një spiuni anglez***, 70 faqe.
- ***Rendi i ri botëror***, 100 faqe.
- ***Si arriti Kur'ani deri në ditët tona***, 70 faqe.

Ka redaktuar një numër të madh librash fetarë, ka botuar me qindra artikuj në organe të ndryshme shtypi brenda e jashtë vendit, ka mbajtur ligjërata në simpoziume e veprimtari të tjera shkencore brenda e jashtë vendit, si në Vjenë, Marok, Libi, Londër, Arabi Saudite etj."

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari , Këshilli i Myftinisë Shkodër, imamët dhe krejt trupa e punonjësve të Myftinisë Shkodër, shprehin ngushëllimet familjes Muçej dhe krejt bashkësisë së muslimanëve shqiptarë për kalimin nga kjo botë e të nderuarit H. Ismail Muçej.

Allahu i Madhëruar e pranoftë veprën e tij dhe shpërbleftë me mirësitë dhe bekimet e Tij!

I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S) KA THËNË:

"Mësojeni diturinë! Mësoni për diturinë qetësinë dhe seriozitetin dhe jini të përulur (modestë) ndaj atyre, prej të cilëve mësoni".

(Transmetuar nga Tabaraniu në "El-Eusat")

MYFTIU PRITI DREJTORIN E KADASTRËS SHKODËR

Paraditën e së martës, më 22 dhjetor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti drejtorin e Drejtorisë Vendore Shkodër të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, z. Genc Berhani.

Gjatë takimit, Myftiu e njoftoi z. Berhani për problematikën e mosregjistrimit të dhjetëra pronave të Myftinisë Shkodër me gjithë interesimin e vazhdueshëm të Myftinisë dhe përpjekjet për legjitimimin e xhamive të shumta në qytet e fshat, duke pasur në vëmendje se të gjitha xhamitë e Shkodrës janë ndërtuar brenda vakëfeve të vjetra të faktuara me dokumentet përkatëse dhe se në asnjë rast nuk kemi shkelje a zaptime në ndërtime, që në Islam janë të ndaluara rreptësisht.

Myftiu dhe drejtori i Kadastrës së Shkodrës ranë dakord për listën e objekteve që presin certifikatën e legalizimit, duke specifikuar prioritetet, për të ndjekur me korrektësi të gjitha etapat për realizimin e qëllimit për legalizimin e ndërtimeve të kryera nga Myftinia Shkodër në tre dekadat e fundit, që në të gjitha rastet janë objekte a qendra komunitare, që i shërbejnë bashkësisë më të madhe fetare në Shkodër e në Shqipëri.

MYFTIU VIZITOI MYFTIUN E MALËSISË SË MADHE

Paraditën e së enjtes, më 24 dhjetor 2020, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune në Myftininë e Malësisë së Madhe, ku u prit nga Myftiu, H. Edmir Smajlaj.

Gjatë takimit të përzemërt u diskutua për rolin e madh që kanë myftinitë për përhapjen e mesazheve të shpresës, mirëkuptimit ndërkomunitar, paqes sociale e mbi të gjitha ndërgjegjësimit fetar e moral të individit dhe shoqërisë.

U diskutua për rrugët e bashkëpunimit institucional dhe ndërveprimit për rritjen e aktiviteteve të përbashkëta dhe zhvillimit të mëtejshëm të takimeve që afrojnë edhe më shumë besimtarët me shpirtin e mësimeve dhe urtësisë së besimit dhe udhëzimit islam.

Të dy myftitë ranë dakord se duhet të bëhet më shumë për evidentimin e kontributit të imamëve dhe hoxhallarëve të shquar të vendit në mbrojtjen e interesit fetar e atij kombëtar, si dhe rolit të madh si pajtimtarë e rregullatorë në shoqëri.

MYFTIU INSPEKTOI PUNIMET PËR PASTRIMIN DHE SISTEMIMIN E VAKËFIT TË AJASMËS

Ditën e enjte, më 24 dhjetor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, inspektoi punimet për pastrimin dhe sistemimin e vakëfit të xhamisë së lagjes Ajasëm.

Myftiu falënderoi muezinin dhe kujdestarin e devotshëm të Ajasmës, të nderuarin z. Latif Ura, që përtej moshës së tij, punon krah për krah me punëtorët që në këto dy ditë i ndryshuan pamjen e jashtme kësaj prone të vjetër vakëf.

Myftinia Shkodër është e angazhuar që të kthejë në origjinë krejt pronat e saj të zaptuara, të nëpërkëmbura nga burokracia (shpesh edhe dashakeqësia) e zyrave të këtyre tre dekadave. Njëkohësisht është e angazhuar të bëjë më të mirën për sistemimin e rrethimit, pastrimit e nxjerrjes në pah të vakëfeve, ashtu siç duhet të jenë e ashtu si e kanë vendin e tyre të shenjtë.

U ZHVILLUA KONFERENCA E 9-TË VJETORE E IMAMËVE ME TEMË: "30 VJET SFIDA, SAKRIFICË, BESIM"

Të shtunën, më 26 dhjetor 2020, në ambientet e xhamisë së "Dy Vajzave", Myftinia Shkodër organizoi konferencën e 9-të vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës.

Ndryshe nga vitet e kaluara, sivjet kjo konferencë u zhvillu me një numër të kufizuar pjesëmarrësish.

Përveç imamëve, anëtarëve të këshillit të Myftinisë, përfaqësuesve të këshillave të xhamive, mori pjesë edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari si dhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, të cilët para të pranishmëve dhanë mesazhe me vlerë e plot dobi me rastin e këtij jubileu të rihapjes së besimit në vendin tonë.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ndër të tjera tha: "Sot, pasi po hedhim një hap të ri drejt vitit 2021, që është edhe fillimi i një dekade të re, përgjegjësi të shumta bien mbi ne, pikëpyetje të shumta duan përgjigje, pengesa e hendeqe të shumta shfaqen në horizont, porse me besim e mbështetje në Allahun e Madhëruar, dorë më dorë dhe në bashkëpunim të shëndetshëm e jo sakat me pjesën tjetër të ymetit, mbi të gjitha me mbështetjen e popullit tonë, patjetër që do të vazhdojmë me krenari të dështmohemi të denjë për të vijuar rrugën e ndërtimit, dështmimit si faktori kryesor i ruajtjes së ekuilibrave shoqëror, i konsolidimit të paqes sociale, i shërbimit ndaj tabanit fetar e kombëtar, shembulli i qytetëruar i përhapësit të vlerave fetare e morale, me sa të kemi forcë e deri në frymën e fundit!"

Më pas, konferenca u zhvillua në dy seanca.

Në seancën e parë u mbajtën këto referate:

"16 nëntori 1990, një datë e shënuar që shënjon drej të ardhmes, Arben Halluni, teolog, "Fikhu i prioriteteve dhe thirrja në shoqërinë tonë", Durim Kasemi, imam i xhamisë Parrucë, "Xhemati dhe rëndësia e tij", Idmir Plaku, imam i xhamisë "Ebu Bekër", "Klasa e re e imamëve teologë dhe pritshmëritë", Adem Pizga, imam i xhamisë Perash

Ndërsa, seanca e dytë kishte këto referate:

"Hapja e xhamive të reja, lehtësim për besimtarët", Gilman Kazazi, imam i xhamisë "Ebu Bekër", "Xhumaja dhe dispozitat e saj", Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave", "Mesazhe me vlerë nga tribuna e gazetës Udha Islame", Ervil Kuçi, imam i xhamisë Dërgut, "Udhëzime të rëndësishme për thirrësin islam", Naim Drijaj, imam i xhamisë së Parrucës.

Vlen të përmendet, se punimet e referateve të mbajtura do të botohen të plota në librin e përvitshëm të konferencës.

Ndërkohë, seanca e motrave teologe, për shkak të situatës pandemike, nuk u zhvillua, por punimet e tyre do të botohen së bashku me temat e referuesve të tjerë.

I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S) KA THËNË:

"Po i posedove katër veçori, mos u dëshpëro për çfarë mund të kesh humbur nga kjo jetë: Sinceriteti i fjalës, ruajtja e amanetit, mirësjellja dhe ruajtja nga ushqimi haram!"

(Transmetuar nga Imam Ahmedi, Tabaraniu, Hakimi dhe Bejhekiu, nga Ibn Omeri).

"Kur do të udhëzohemi drejt esencës së gjërave dhe thelbit të çështjes dhe të kuptojmë, se feja është dije, punë dhe moral i lartë;

- Se ixhtihadi (interpretimi) nuk e dëmton fenë, por ia shton prodhimtarinë e saj;

- Se diversiteti është themeli i pasurisë së shoqërive, nëse përkthehet (konvertohet) në ide dhe vepra.

- I tërë qytetërimi ka qenë dhënie e njerëzve të ndryshëm, por ata ka ditur se si të ndryshojnë, për të dhënë e për të plotësuar, jo për të shembur (shkatërruar) njëri-tjetrin!"

"NUK KA ASNJË UDHËHEQËS QË E MBRON KAQ HAPUR ISLAMIN SA ERDOĞANI"

MAME MACTAR GUEYE

RECEP TAYYIP ERDOĞAN

Nuk ka asnjë udhëheqës që e mbron kaq hapur Islamin sa Erdoğani.

Zëvendës kryetari i organizatës joqeveritare "Jamra" në Senegal, Mame Mactar Gueye zgjodhi presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, "Personaliteti i vitit 2020".

Gueye, zv/kryetari i "Jamra" që zhvillon aktivitete në fushat e arsimit, Islamit dhe çështjeve sociale që nga viti 1983, në një prononcim për Anadolu Agency (AA) vlerësoi se pse kanë zgjedhur presidentin turk për "Personalitet të vitit".

Ai tregoi se si organizatë që nga viti 2015 janë duke zgjedhur "personalitetet e vitit" në mesin e emrave që kanë kontribuar për shoqërinë.

"Deri më sot kishim zgjedhur senegalezët që kanë kontribuar për këtë shoqëri, por këtë vit dëshiruam të bëjmë një gjë më ndërkombëtare. Derisa mendonim se kush mund të jetë i dobishëm për gjithë njerëzimin e jo vetëm Senegalin, përcaktuam 4 emra. Nuk do t'i tregojë 3 emrat tjerë por vendimi i përbashkët i të gjithëve ishte Erdoğani. Për herë të parë zgjodhëm një emër jashtë Senegalit. Ishim 30 persona, asnjëri nuk kundërshtoi. Vërejtëm një gjë se përveç Erdoğanit, nuk ka udhëheqës tjetër në botë që e mbron kaq hapur Islamin", u shpreh ai.

"E zgjodhëm 'Personalitet të vitit' Erdoğanin për shkak të guximit të tij në krizën e karikaturave në të cilën u portretizua Profeti Muhammed, për shkak të qëndrimit që mori kundër Islamofobisë në tërë botën dhe mbështetjes së tij ndaj komuniteteve të persekutuara", shtoi Gueye.

"Lidhja që Erdoğan krijoi me ne është ndryshe nga ajo e kolonialistëve"

Gueye më tej rikujtoi se presidenti Erdoğan ka krijuar një marrëdhënie të bazuar në parimin 'fito-fito' me Afrikën e veçanërisht me Senegalin, duke potencuar se "Erdoğan krijoi me ne një lidhje të drejtë në përputhje me thelbin e Islamit, e jo si ish-kolonialistët me mendimin se 'nuk mund të bësh asgjë pa ne'".

Ai gjithashtu tërhoqi vëmendjen se presidenti turk nuk ka mbetur i heshtur ndaj fjalëve të presidentit francez, Emmanuel Macron që kanë shënjestruar Islamin. "Erdoğan edhe njëherë mori përsipër përpjekjen. Bëri thirrje për bojkot të produkteve franceze", tha Gueye.

"Jamra", sipas Gueye, më 26 tetor i ka dërguar një letër proteste ambasadës franceze në Dakar si dhe ka organizuar një protestë të madhe me pjesëmarjen e shumë organizatave joqeveritare në mbarë vendin më 7 nëntor kundër Islamofobisë.

Gueye më tej u shpreh se dëshirojnë që t'i japin një dhuratë simbolike presidentit Erdoğan, por nuk dinë si ta bëjnë këtë.

(www.mesazhi.com)

MEJTEPI I IM... XHAMIA URA E BUNËS

PAK HISTORI:

- Xhamia e lagjes Ura e Bunës, ndodhet brenda territorit të Bashkisë Shkodër.

- Përbëhet prej rreth 96 familje myslimane.

- Xhamia e re është ndërtuar në vitin 2018, pikërisht më 16 nëntor të po të njëjtit vit është zhvilluar ceremonia e përurimit. Xhamia është financuar nga biznesmeni haxhi Gani Kryeziu.

- Vlen të kujtojmë se xhamia e re është ndërtuar në të njëjtin tokë-vakëf. Xhamia e parë është ndërtuar nga vetë Ibrahim Pasha, vezir i Shkodrës, në vitet 1706-1809. Pas një dëmtimi nga kushtet atmosferike, në vitin 1899 xhami u rindërtua nga marshalli turk, valiu i Shkodrës, Qazim Pasha .

Xhamia u prish nga dora kriminale e sistemit komunist në vitin famëkeq 1967.

Gjatë viteve në këtë xhami kanë shërbyer këta imamë: Molla Rexhep Kraja, Sheh Ahmet Shkodra dhe Hafiz Ibrahim Hali.

- Ndërsa në xhaminë e re nga viti 2018 e deri më sot kan shërbyer si imam dhe mësues të mejtepeve Taksim Plori si dhe imami aktual Ridvan Luzaku.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht në 4 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami, në periudha të ndryshme nga viti 2018 -2020 është rreth 65 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadër të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi para pak muajve takimin e radhës me nxënësit e kursit fetarë të xhamisë Ura e Bunës.

Në fillim, përgjegjësi i arsimit u mbajti një bisedë rreth rëndësisë dhe vlerës që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin te brezi i ri, për të përçuar te ata mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit xh.sh.

Më pas, drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi Ridvan Luzaku.

Gjatë këtij aktiviteti u zhvillu edhe një bashkëbisedim me nxënësit në lidhje me njohuritë fetare e edukative qe ata marrin gjatë kursit të mësim-besimit.

Ndërkaq, teologu Halluni dha edhe udhëzimi për të respektuar masat e thjeshta parandaluese antiCovid, sikurse u lut që Zoti të sjellë normalitetin në jetën njerëzore dhe në çdo aspekt të saj.

Kalendari - 2021

DITËT DHE NETËT E SHËNUARA ISLAME PËR VITIN 2021 1442-1443 HIXHRI

10.03.2021 - Nata e Israsë dhe Miraxhit

27.03.2021 - Nata e Beraetit

13.04.2021 - Dita e parë e Ramazanit

08.05.2021 - Nata e Kadrit

13.05.2021 - Dita e parë e Fitër Bajramit

Bajrami falet në orën 06:10

19.07.2021 - Dita e Arafatit

20.07.2021 - Dita e parë e Kurban Bajramit

Bajrami falet në orën 06:20

09.08.2021 - Dita e parë e Vitit të Ri Hixhri 1443

18.08.2021 - Dita e Ashurasë

17.10.2021 - Ditëlindja e Profetit Muhammed (a.s)

Janar

H	M	M	E	P	S	D
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

Shkurt

H	M	M	E	P	S	D
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28

Mars

H	M	M	E	P	S	D
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

Prill

H	M	M	E	P	S	D
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

Maj

H	M	M	E	P	S	D
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

Qershor

H	M	M	E	P	S	D
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

Korrik

H	M	M	E	P	S	D
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

Gusht

H	M	M	E	P	S	D
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

Shtator

H	M	M	E	P	S	D
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

Tetor

H	M	M	E	P	S	D
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

Nëntor

H	M	M	E	P	S	D
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30					

Dhjetor

H	M	M	E	P	S	D
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek